



Republika e Kosovës | Republika Kosova | Republic of Kosova
Komuna e Podujevës | Opština Podujevo | Municipality of Podujeva

Drejtoria për Pronë Kadaster dhe Gjeodezi

Procesverbal i mbajtur më 23 mars 2021 , në debat publik për Propozim Rregulloren për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës së Podujevës.

Mbledhja filloj në orën 10;00 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi zBahrije Shatrolli-Mehmeti.

Në mbledhje të pranishëm ishin përfaqësues të lokaliteteve dhe fshatrave të Komunës së Podujeves , qytetar te interesuar dhe zyrtar tjerë komunal (Lista e nënshkrimeve 27 pjesmarrës)

Rendi i Ditës

Propozim Rregulloren për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës së Podujevës.

Z.Bahrije Shatrolli-Mehmeti , foli për dispozitat e përgjithshme dhe parimet sipas të cilave përcaktohen kushtet dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim te pronës se paluajtshme të Komunes per interes publik. Pas përfundimit të leximit të rregullores te pranishmeve iu dha fjala per pyetjet dhe sugjerimet e tyre.

Z Enver Latifi i përgëzoj të pranishmit dhe ju uroj suksese .

Z.Mustaf Hajdari përfaqësues i Podujeva 2 ,pyeti se a do të përfshihen në komisione edhe përfaqësues të shoqërisë civile apo vetëm antar të brendshëm?

Znj.Bahrije Shatrolli-Mehmeti ,tha se kjo projekt rregullore është bërë në bazë të asociacionit të Komunave ecila ka parapa qe ne komisione te bëjnë pjese vetëm antare te brendshëm.

Z. Abaz Llugaliu përfaqësues i fshatit Surkish , beri vërejtje se duhet të ketë kopje fizike për çdo pjesëmarrës .

Znj Elheme Kutllovci . tha se projekt rregullorja është e në Wueb faqen e Komunës së Podujevës dhe ne rrjetës sociale.

Znj.Bahrije Shatrolli-Mehmeti Pasi nuk pati të tjerë të interesuar për të marrë fjalën drejtoresha i falënderoj të pranishmit per pjesëmarrje dhe kontribut , si dhe iu sugjeroj qe propozimet sugjerimet apo vrejttet eventuale mund ti dërgojnë edhe në form elektronike deri në përmbylljen e diskutimit publik sipas vendimit përkatës .


Procesmbajtës

Ardiana Dibrani

ADi Dibrani

Nr.prot 08-060/04-0040494/21

Podujevë 23.03.2021



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA PËR PRONË KADASTËR DHE GJEODEZI

Tema: Raport i Diskutimit Publik për propozim rregullor për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës

Bazuar në Vendimin nr.01-462/01-0022453/21, të datës 10 mars 2021 mbi vënien në diskutim publik të Projekt Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës për personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Podujevës.

Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim të Komunës së Podujevës, duke u bazuar në nenet 11 dhe 12.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 pika 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 7 të Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe në bazë të udhëzuesit praktik të hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës- Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjorë pas hartimit të Projekt Rregullore, qytetarët përmes Vendimit nr.01-462/01-0022453/21 të datës 10 mars 2021 kanë qenë të informuar se propozimet, sugjerimet apo vërejtjet eventuale prej datës 15 mars 2021 deri me datë 15 prill 2021 mund të paraqiten në formë të shkruar në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim si dhe në dy adresat elektronike të publikuara në këtë Vendim si dhe dita e debati publik është mbajtur me 24 mars 2021 ashtu si ka qenë e përcaktuar.

Në këtë debat kanë qenë të pranishëm 27 qytetarë të Komunës së Podujevës me ç'rast edhe qytetarët shfaqën falënderime dhe mirënjohje për transparencën komunale si dhe u informuar në tersi për Projekt Rregullorin dhe për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në përgjithësi është mirëpritur këtë Projekt Rregullor dhe nuk kanë pasur vërejtje, përveç njërit nga qytetarët i cili ka pyetur tek përbërja e komisionit a parashihen vetëm

anëtar të brendshëm apo edhe përfaqësues të shoqërisë civile i cili është informuar se në bazë të Projekt Rregullore Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit vlerësues në të cilin parashihen të jenë anëtarë vetëm zyrtar të drejtorive përkatëse. Ndërsa në formën elektronike apo të shkruar është pranuar një propozim, nga z. Abaz Llugaliu ka paraqitur vërejtjet e ti si ne vijim:

1. Neni 2 " në territorin e komunës së Podujevës" vj. (vretja jonë). (të hiqet për arsye se shkel parimin e trajtimit të brabarët të palëve, duke prejudikuar se palë që mund ta marrin në shfrytëzim pronën e paluajtshme duhet të jenë vetëm personat fizik dhe juridik në territorin e komunës, e qka i përjashton personat e komunave tjera dhe shtetasit e huaj.

2. Neni 5 paragrafi 2 pikat:

2.1 Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese

2.4 Lokalet në pronësi të komunës

Vj. Qka nëse për një nga këto prona keni më shumë se një kërkesë nga palët e interesuara për cilën do të vendos komisioni vlerësues? Kjo është pyetje hipotetike por në praktikë mund të ndodhë. Propozimi im për këto raste është që komisioni vlerësues ti zbatoj dispozitat e ligjit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës për shfrytëzim afatshkurtër, për ndryshe do keni probleme me qytetarë dhe do shkelet parimi i trajtimit të barabartë të palëve.

Neni 5 paragrafi 2 pikat: 2.2; 2.3 dhe 2.5:

2.2 Shtëpitë e kulturës, kinemat, teatrot dhe terrenet rekreative- sportive.

2.3 Hapësirat publike para lokaleve afariste

2.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve.

Vj. Meqë për këto prona nuk mund të ketë konkurrent për shfrytëzimin e tyre sepse për një hapësirë publike para lokalit afarist, ose hapësirës publike rreth vend punishteve mund t'iu ipet në shfrytëzim vetëm pronarit të lokalit afarist, dhe ati të vendpunishteve, se po ti ipet ndonjë pale tjetër do i fut në konflikt palët kërkuese.

Sugjerimi im është që për këto raste të përdoren dispozitat e nenit 9 paragrafi 3 dhe 4 i kësaj Rregulloreje, dhe këto prona të jepen në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës së palës, dhe aprovimi nga drejtori i drejtorisë gjegjëse, duke e përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues. Po ashtu kontratat duhet të lidhen në mes të drejtorit të drejtorisë gjegjëse dhe plës kërkuese, duke e kursyer kryetarin e komunës, meqë rastet të hapësirave publike para lokaleve afariste përsëriten qdo vit nga palët kontraktuese të njëjta për pronat që jepen në shfrytëzim gjatë sezonës verore.

Propozoj: që nenit 9 ti shtohet paragrafi 5 "Pronarët e lokaleve afriste, dhe ata të vendpunishteve, mund t'iu jepen në shfrytëzim prona e paluajtshme e komunës për periudhën më pak se 1 vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimin nga drejtori i drejtorisë gjegjëse, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesave për këto raste nga komisioni vlerësues

Neni 5 paragrafi 3 në fund të paragrafit thuhet Rregulloren e komunës për taksa ti shtohet: " tarifa dhe gjoba".

Neni 14 Mbikqyrja e kontratës

Propozoj: të hiqen këta paragraf: 1; 2 dhe 3, për arsye se të njëjtit paragraf janë obligativ dhe përfshihen në kontratat e lidhur mes palëve kontraktuese.

E nëse nuk hiqen këta paragraf ne nenin 14 të shtohet një paragraf i ri pas paragrafit 3 në të cilin

do shkruhej :

3a "E drejta e shkëputjes së kontratës nga qeramarrësi i lejohet duke kryer obligimin e qerasë për sa kohë e ka shfytëzuar pronën e paluajtshme të komunës".

Sa i përket këtyre sugjerimeve ne e kemi parë të arsyeshme të inkorporohen vetëm tek neni 5 paragrafi 3 në propozim rregulloren pasi që rregullorja në fjalë është hartuar duke respektuar dispozitat e Ligjit përkatës (Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe Rregullores nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës) dhe si draft është përgatitur nga ekspert të fushës në bashkëpunim edhe me përfaqësues të MAPL-së dhe është pothuajse e ngjashme në të gjitha Komunat e Kosovës.

Me respekt,

Drejtori i DPKGJ:
Bahrije Sh.Mehmeti

